

PËRMBUSHJE E OBJEKTIVIT PËR KRIJIMIN E RASTEVE TË SUKSESSHME NËPËRMJET PËRFAQËSIMIT FALAS TË SHTETASVE PRANË SISTEMIT GJYQËSOR



Nga momenti kur vendi ynë u godit nga Covid 19, u konstatua një rritje e numrit të ankesë/kërkesave të shtetasve të privuar nga liria. E drejta për proces të rregullt ligjor u riskua. Shqyrtimi i çështjeve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme, u shndërrua në mision për mbrojtësit ligjorë, për të rivendosur në vend të drejtat e cënuara kësaj kategorie të shoqërisë.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk zbatuan një praktikë të unifikuar për trajtimin dhe shqyrtimin e proceseve gjyqësore, ndërkohë që prezenca fizike në sallën e gjyqit ose pjesëmarrja në gjykimin online u la në vullnetin e të paraburgosurit/dënuarit.



CILAT ISHIN DISA NGA RASTET E SUKSESIT, KU FALË ASISTENCËS LIGJORE TË KSHH, SHTETASVE TË PARABURGOSUR/ DËNUAR IU RIKTHYE LIRIA, NDËRSA QYTETARËVE JU RIVENDOS NË VEND E DREJTA E CËNUAR PREJ VITESH ?

Nga viti 2017 KShH po përfaqëson ligjërisht shtetasen B.A., pjesë e komunitetit rom egjyptian, në kushte tepër të vështira socio-ekonomike dhe shëndetësore.

Për shkak të mungesës së dokumentacionit ajo nuk mundej të provonte vitet e punës, duke u privuar nga e drejta e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë.

Pas një kalvari të gjatë procesesh gjyqësore Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës vendosi pranimin e kërkesë-padisë, duke urdhëruar institucionet kompetente që t'i akordonin pensionin e pleqërisë qytetares.



Shtetasi G.S. i akomoduar në IEVP Fushë Krujë rezultonte se ishte arrestuar si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe qëndronte prej 7 muajve në seksionin e paraburgimit të këtij institucioni.

Institucioni akomodues kishte mundësuar lejimin e martesës së këtij shtetasi, si rrjedhojë e të cilës ka ardhur në jetë një fëmijë.

Duke vlerësuar moshën e të miturit dhe domosdoshmërinë e përkujdesit prindëror, avokatët e KShH-së përfaqësuan shtetasi G.S duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit.

Gjykata e Shkallës së Parë Krujë vendosi pranimin e kërkesës dhe ndryshimin e masës së sigurimit personal në atë arrest në shtëpi, duke mundësuar zhvillimin dhe rritjen e të miturit nën përkujdesjen e babait.

A KA PASUR SHTETAS TË HUAJ TË CILËT I JANË DREJTUAR KSHH PËR ASISTENCË LIGJORE?

Stafi ligjor i KShH u njoh me kërkesën e përcjellë nga shtetasi turk B.A. Ky shtetas i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, prej afro 7 muajve qëndrontë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në kushte tepër të vështira ekonomike dhe në vështirësi për të kuptuar efektivisht proceset gjyqësore, ai kërkoi ndihmë nga ana e stafit ligjor të KShH-së.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi shuarjen e masës së sigurimit për këtë shtetas dhe kthimin e dokumentave të sekuestruara, duke konstatuar se koha e vuajtur në paraburgim është e mjaftueshme për qëllimin e sanksionit penal.

Pas marrjes së vendimit formë e prerë, ky shtetas mund të udhëtojë drejt vendit të tij të origjinës dhe të riintegrohet në shoqëri, pranë familjarëve të tij



NË RAST SE KENI NEVOJË PËR ASISTENCË LIGJORE FALAS MUND TË NA KONTAKTONI NË NUMRAT TANË TË KONTAKTIT:

**+355 (0)4 223 3671
068 20 236 99
069 40 757 32**

NË ADRESËN ELEKTRONIKE OFFICE@AHC.ORG.AL

**OSE NË ADRESËN POSTARE: RRUGA BRIGADA E VIII , KULLA "TEKNO PROJEKT" , SHKALLA 2, APARTAMENTI 10, KATI 6
KODI POSTAR 1752
TIRANË, SHQIPËRI**